



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2019 – Numri: 9

Tiranë – E hënë, 4 shkurt 2019

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Kuvendit nr. 24/2019, datë 31.1.2019	Për ngritjen e Komisionit Hetimor të Kuvendit për të kontrolluar ligjshmërinë e veprimeve të organeve të pushtetit ekzekutiv dhe të institucioneve të tjera shtetërore në pajisjen e z. Gent Cakaj me “Certifikatë të sigurimit të personelit” dhe hetuar nëse z. Cakaj ka pasur qasje në informacione të klasifikuara pa qenë i pajisur më parë me këtë dokument në cilësinë e tij si zëvendësministër për Evropën dhe Punët e Jashtme apo detyra të tjera shtetërore.....
	253
Vendim i Kuvendit nr. 25/2019, datë 31.1.2019	Për rrëzimin e dekretit nr. 11 063, datë 19.1.2019, të Presidentit të Republikës, “Për propozimin e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit”
	254
Vendim i Kuvendit nr. 26/2019, datë 31.1.2019	Për një ndryshim në vendimin e Kuvendit nr. 74/2018 “Për ngritjen e Komisionit të Pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe Ndjekjen e zbatimit të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”
	254
Vendim i Kuvendit nr. 28/2019, datë 31.1.2019	Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 102/2017 “Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për realizimin e reformës zgjedhore”, të ndryshuar.....
	255
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 41, datë 30.1.2019	Për emërim në detyrë.....
	255
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 46, datë 30.1.2019	Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2019.....
	255
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 47, datë 30.1.2019	Për miratimin e paketës së programit kombëtar të depistimit të kancerit të qafës së mitrës në Shqipëri.....
	260
Urdhër i Drejtorit të Përgjithshëm të Arkivave nr. 53, datë 29.1.2019	Për delegimin e kompetencave të kryeinspektorit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave.....
	261

Urdhër i përbashkët i ministrit të
Arsimit Sportit dhe Rinisë dhe
i ministrit të Financave dhe
Ekonomisë nr. 54, datë 30.1.2019

Për miratimin e formatit të publikimit të të dhënave të detajuara mbi të
ardhurat dhe shpenzimet financiare të institucioneve publike të arsimit të
lartë.....



**VENDIM
Nr. 24/2019**

**PËR NGRITJEN E KOMISIONIT
HETIMOR TË KUVENDIT PËR TË
KONTROLLUAR LIGJSHMËRINË E
VEPRIMEVE TË ORGANEVE TË
PUSHTETIT EKZEKUTIV DHE TË
INSTITUCIONEVE TË TJERA
SHTETËRORE NË PAJISJEN E Z. GENT
CAKAJ ME “CERTIFIKATË TË
SIGURIMIT TË PERSONELIT” DHE
HETUAR NËSE Z. CAKAJ KA PASUR
QASJE NË INFORMACIONE TË
KLASIFIKUARA PA QENË I PAJISUR MË
PARË ME KËTË DOKUMENT NË
CILËSINË E TIJ SI
ZËVENDËSMINISTËR PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME APO DETYRA
TË TJERA SHTETËRORE**

Në mbështetje të neneve 7, 77 dhe 78, të Kushtetutës, të neneve 5, 6, 8 e 9, të ligjit nr. 8891, datë 2.5.2002, “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”, si dhe të nenit 25, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e një të katërtës së deputetëve,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

I. Ngritjen e Komisionit Hetimor të Kuvendit për shqyrtimin e kërkesës së një grupi deputetësh, për të kontrolluar ligjshmërinë e veprimeve administrative të organeve të pushtetit ekzekutiv dhe të institucioneve të tjera shtetërore në pajisjen e z. Gent Cakaj me “Certifikatë të sigurisë” dhe hetuar nëse z. Cakaj ka pasur qasje në informacione të klasifikuara pa qenë i pajisur më parë me këtë dokument, në cilësinë e tij si zëvendësministër për Evropën dhe Punët e Jashtme apo detyra të tjera shtetërore.

II. Ky hetim do të synojë mbrojtjen e sigurisë kombëtare, shtetin e së drejtës dhe demokracinë funksionale, me qëllim parandalimin e pasojave negative për shtetin, qytetarët dhe interesin publik, si dhe nxjerrjen e përgjegjësive konkrete institucionale.

III. Objekti i punës së Komisionit Hetimor, është:

1. Verifikimi i ligjshmërisë dhe i veprimeve të institucioneve shtetërore në pajisjen e z. Gent Cakaj me “Certifikatë të sigurimit të personelit (CSP)”, nga DSIK-ja.

2. Roli i Këshillit të Ministrave, Kryeministrit apo ministrave përgjegjës në ndjekjen dhe zbatimin e procedurave dhe rregullave për garantimin e informacionit “sekret shtetëror” dhe të procedurave për pajisjen e z. Cakaj me CSP.

3. Arsyet e mospajisjes me CSP të z. Gent Cakaj, për 7 muaj dhe verifikimi i pasojave që ka sjellë për sigurinë kombëtare dhe angazhimet e Shqipërisë, si vend anëtar i NATO-s dhe vend kandidat për në BE.

4. Verifikimi nëse autoritetet përgjegjëse kanë lejuar z. Cakaj të administrojë dhe përpunojë informacion të klasifikuar, pa qenë më parë i pajisur me “Certifikatë sigurie”.

IV. Komisioni ka të drejtë të hetojë dhe të bëjë transparencë të plotë për çdo çështje që përfshihet në objektin e punës së tij, në përputhje me parimet kushtetuese dhe përcaktimet e ligjit nr. 8457, datë 11.12.1999, “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror””, të ndryshuar, veçanërisht parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve, si dhe duke respektuar dhe duke mos mbivendosur kompetencat e organeve të drejtësisë.

V. Komisioni Hetimor, i ngritur sipas këtij vendimi, bashkë me raportin përfundimtar i paraqet Kuvendit në seancë plenare rekomandime në lidhje me nxjerrjen e përgjegjësive institucionale, ndryshime apo miratime ligjesh dhe, sipas rastit, njoftimin e prokurorisë për marrjen e masave të mëtejshme ligjore.

VI. Komisioni Hetimor Parlamentar përbëhet nga 9 anëtarë, si më poshtë:

- | | | |
|---------------------|-----------------|--------|
| 1. Enkelejd Alibeaj | kryetar | (PD), |
| 2. Ermonela Felaj | zëvendëskryetar | (PS), |
| 3. Xhemal Qefalia | anëtar | (PS), |
| 4. Klotilda Bushka | anëtar | (PS), |
| 5. Alket Hyseni | anëtar | (PS), |
| 6. Spartak Braho | anëtar | (PS), |
| 7. Ervin Salianji | anëtar | (PD), |
| 8. Xhemal Gjunkshi | anëtar | (PD), |
| 9. Luan Rama | anëtar | (LSI). |

Kryetari dhe të gjithë anëtarët e Komisionit Hetimor duhet të jenë të pajisur me CSP të kategorisë “sekret”.



VII. Komisioni e ushtron veprimtarinë e tij për një afat 3-mujor nga miratimi i këtij vendimi.

VIII. Ngarkohet Kryetari i Kuvendit që menjëherë të caktojë mjediset dhe mjetet e punës së komisionit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e legjislacionit në fuqi për sigurimin e informacionit të klasifikuar, si dhe personelin e nevojshëm, duke vënë në dispozicion edhe ekspertë juristë, të cilët, gjithashtu, duhet të jenë të pajisur me CSP të kategorisë “sekret”.

IX. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit që të marrë masa për zbatimin e vendimit të Kuvendit dhe të urdhrave të Kryetarit të Kuvendit për mbarëvajtjen e punës së komisionit, si dhe krijimin e kushteve të nevojshme logjistike për veprimtarinë normale të tij.

X. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Gramoz Ruçi

Miraturar në datën 31.1.2019.

VENDIM
Nr. 25/2019

PËR RRËZIMIN E DEKRETIT NR. 11
063, DATË 19.1.2019, TË PRESIDENTIT
TË REPUBLIKËS, “PËR PROPOZIMIN E
KRYETARIT TË KONTROLLIT TË
LARTË TË SHTETIT”

Në mbështetje të nenit 20 të ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe nenit 111, pika 7, të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Mosmiratimin e kandidaturës së zotit Bahri Shaqiri, të propozuar me dekretin nr. 11 063, datë 19.1.2019, të Presidentit të Republikës, “Për propozimin e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Gramoz Ruçi

Miraturar në datën 31.1.2019

VENDIM
Nr. 26/2019

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E
KUVENDIT NR. 74/2018 “PËR
NGRITJEN E KOMISIONIT TË
PAVARUR PËR KOORDINIMIN,
MONITORIMIN DHE NDJEKJEN E
ZBATIMIT TË LIGJIT NR. 115/2016 “PËR
ORGANET E QEVERISJES SË SISTEMIT
TË DREJTËSISË”

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, e Kushtetutës, të nenit 288 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” dhe të nenit 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozim deputeti,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Pika X e vendimit të Kuvendit nr. 74/2018 “Për ngritjen e Komisionit të Pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe Ndjekjen e zbatimit të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë””, ndryshohet si më poshtë:

“X. Masa e Shpërblimit të anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe Ndjekjen e zbatimit të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” vendoset si më poshtë:

a) Kryetari i Komisionit të Pavarur, për çdo mbledhje, në të cilën është prezent, përfiton shpërblim në masën prej 30 për qind të pagës mujore bruto të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor/ Këshillit të Lartë të Prokurorisë, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” dhe ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

b) Anëtarët Komisionit të Pavarur, për çdo mbledhje, në të cilën janë prezent, përfitojnë secili shpërblim në masën prej 25 për qind të pagës mujore bruto të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor/ Këshillit të Lartë të Prokurorisë, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” dhe



ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë;

c) Stafi i Kuvendit, që angazhohet me veprimtari në mbështetje të Komisionit të Pavarur, përfiton shpërblim mbi pagën në masën e vendosur nga Byroja e Kuvendit.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet që prej ditës së emërimit të anëtarëve të Komisionit të Pavarur.

KRYETARI
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 31.1.2019.

VENDIM
Nr. 28/2019

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN
E KUVENDIT NR. 102/2017 “PËR
NGRITJEN E KOMISIONIT TË
POSAÇËM PARLAMENTAR PËR
REALIZIMIN E REFORMËS
ZGJEDHORE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 77, pika 1, dhe 78, pika 1, të Kushtetutës, si dhe neneve 24 dhe 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në pikën V të vendimit të Kuvendit nr. 102/2017 “Për ngritjen e komisionit të posaçëm parlamentar për realizimin e reformës zgjedhore”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

I. Deputetja Blerina Gjylameti (PS) caktohet bashkëkryetare në vend të deputetit Bledar Çuçi.

II. Deputeti Damian Gjiknuri (PS) caktohet anëtar.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 31.1.2019.

VENDIM

Nr. 41, datë 30.1.2019

PËR EMËRIM NË DETYRË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Sokol Dedja emërohet zëvendësministër për Evropën dhe Punët e Jashtme.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 46, datë 30.1.2019

PËR FINANCIMIN E SHËRBIMEVE
SHËNDETËSORE SPITALORE NGA
SKEMA E DETYRUESHME E
SIGURIMEVE TË KUJDESIT
SHËNDETËSOR PËR VITIN 2019

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr.99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, dhe të nenit 10, të ligjit nr.10383, datë 24.2.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI

1. Financimin nga skema e detyrueshme e sigurimeve shëndetësore të paketës së shërbimeve të ofruara në spitalet publike, sipas listës së shërbimeve, dhënë në shtojcën nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Spitali është person juridik, publik, me buxhet të pavarur, me cilësinë e autoritetit kontraktor, i cili organizohet, administrohet dhe vepron sipas ligjit nr. 9106, datë 17.7.2003, “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

3. Spitali e ushtron veprimtarinë e tij në



përputhje me standardet, treguesit e cilësisë e të performancës, protokollet e diagnozës e të trajtimit, të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

4. Buxheti për mbulimin e paketës së shërbimeve spitalore, sipas listës së shërbimeve që ofron çdo spital, ndahet sipas shtojcës nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

5. Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor lidh kontratat me spitalet për financimin e paketave të shërbimeve shëndetësore të ofruara prej tyre.

6. Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor financon paketën e shërbimeve spitalore të kontraktuara me këto metoda:

a) Buxhetim me zëra shpenzimesh, për:

i. paga dhe shpenzime të tjera lidhur me pagën e personelit;

ii. kontribute për sigurime shëndetësore e shoqërore të personelit;

iii. mallra e shërbime të tjera.

b) Buxhetim global për pagesën e paketave të shërbimeve me çmime të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave. Buxheti global detajohet për çdo spital në zëra shpenzimesh me vendim të Këshillit Administrativ të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

7. Spitali është përgjegjës për zbatimin e buxhetit të kontraktuar, sipas zërave të përcaktuar të buxhetit.

8. Rishpërndarja e buxhetit ndërmjet spitaleve bëhet brenda një kufiri prej 3% të buxhetit të spitaleve, me vendim të Këshillit Administrativ të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

9. Një fond jo më i madh se 27% e buxhetit vjetor, i planifikuar për shërbimet spitalore, mbahet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për ta shpërndarë gjatë vitit, me vendim të Këshillit Administrativ të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, përkatësisht, për:

a) financimin e shërbimit spitalor gjatë vitit;

b) pagesat e paketave të shërbimeve të veçanta, të ofruara nga shërbimet spitalore, publike e jopublike, brenda e jashtë vendit, të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave;

c) pagesat për kujdes shëndetësor në institucione jopublike, brenda e jashtë vendit, sipas

miratimit, rast pas rasti, me vendim të Këshillit të Ministrave;

ç) pagesat për kujdes shëndetësor, sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të nënshkruara;

d) pagesa të shërbimeve të kryera për llogari të spitaleve publike nga operatorë të kontraktuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, sipas legjislacionit për partneritetin publik privat;

dh) transferta për individët (mjekë specialistë).

10. Shpenzimet kapitale për investimet në spitale mbulohen nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor vlerëson kërkesat e spitaleve (rajonale/bashkiake) për investimet dhe ia paraqet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për miratim. Spitalet universitare e paraqesin kërkesën për investime në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

11. Burime të tjera financimi për spitalet janë fondet e krijuara nga të ardhurat e realizuara gjatë veprimtarisë së tyre dhe nga dhurimet. Përdorimi i tyre bëhet tërësisht nga vetë spitali, si pjesë e kostos së shërbimit, bazuar në procedurat e miratuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Këto të ardhura vlerësohen si të ardhura jashtë limitit.

12. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për raste të vlerësuara nga ajo ose me kërkesë të autoriteteve kontraktuese (spitaleve), mund të zhvillojë procedura të përqendruara prokurimi për disa mallra, shërbime dhe investime.

13. Spitali zbaton sistemin e referimit dhe tarifat për shërbimet me pagesë, të miratuara nga ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

14. Mënyra e pagesës dhe e shpërblimit të punës së punonjësve të spitaleve, që kanë lidhur kontratë me Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, sipas këtij vendimi, përcaktohet me vendim të Këshillit Administrativ të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

15. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale auditon spitalin, nëpërmjet strukturës së saj audituese, për zbatimin e standardeve të miratuara prej saj dhe për raste të tjera me urdhër të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

16. Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor dhe Operatori i Shërbimeve



të Kujdesit Shëndetësor kontrollojnë, monitorojnë buxhetin spitalor, vlerësojnë aktivitetin vjetor të spitaleve dhe treguesit e performancës nëpërmjet strukturave të tyre audituese dhe kontrolluese, sipas kushteve të përcaktuara në kontratën e financimit. Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor monitoron dhe vlerëson performancën e punonjësve të spitaleve rajonale dhe bashkiake sipas treguesve të kontratës së financimit.

17. Marrëdhëniet juridike të punës në spitale rregullohen në përputhje me ligjin nr.7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

18. Numri i përgjithshëm i punonjësve të spitaleve është 12 016 (dymbëdhjetë mijë e gjashtëmbëdhjetë) veta, nga të cilët 141 (njëqind e dyzet e një) punonjës në Spitalin Universitar të Traumës për Shërbimin e Urgjencës Ambulatore dhe Shërbimin e Ortopedi-Traumatologjisë. Numri dhe struktura e punonjësve për çdo spital miratohen nga ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

19. Për raste të veçanta të mungesës së mjekut specialist në shërbime të ndryshme të spitaleve rajonale e bashkiake, ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, brenda numrit të përgjithshëm të personelit spitalor, urdhëron kontraktimin, për një periudhë të caktuar, të mjekëve specialistë, sipas nevojave. Këta mjekë të specialiteteve të ndryshme, përveç pagës, trajtohen financiarisht me një bonus deri në 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë në muaj. Vlera e bonusit përcaktohet, rast pas rasti, nga ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Ky bonus, për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, trajtohet sipas shkronjës “e”, të pikës 2, të kreut II, të vendimit nr.77, datë 28.1.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe siguri i kujdesit shëndetësor”, të ndryshuar.

20. Mjekët e kontraktuar, sipas pikës 19, të këtij vendimi, nuk e përfitojnë shpërblimin sipas shkronjave “a” e “b”, të pikës 9/1, të vendimit nr.555, datë 11.8.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës dhe nivelit të pagave të punonjësve me arsim të lartë në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Spitalin Ushtarak Qendror Universitar, të punonjësve të

infirmieristikës në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Mbrojtjes, si dhe për trajtimin e mjekëve në strukturat e Forcave të Armatosura”, të ndryshuar.

21. Numri i pedagogëve me kontratë shërbimi për spitalet universitare miratohet nga ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Pagesa e tyre bëhet nga buxheti i spitalit.

22. Financimi i institucioneve dhe i shërbimeve, të përcaktuara në shtojcën nr. 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi, bëhet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, vetëm kundrejt shtesave përkatëse në buxhet, nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

23. Vendimi nr.17, datë 12.1.2018, i Këshillit të Ministrave, “Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2018”, i ndryshuar, shfuqizohet.

24. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i fillon efektet nga data 1 janar 2019.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

SHTOJCA NR. 1
LISTA E SHËRBIMEVE SPITALORE QË
DO TË FINANCOHEN NGA FONDI
I SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË
KUJDESIT SHËNDETËSOR

I. SPITALET UNIVERSITARE

1. Shërbimi i kardiologjisë:
 - a) Hemodinamika;
 - b) Reanimacioni i kardiologjisë.
2. Shërbimi i kardiokirurgjisë;
3. Shërbimi i kirurgjisë angiovaskulare;
4. Shërbimi i hematologjisë;
5. Shërbimi i gastrohepatologjisë;
6. Shërbimi i endokrinologjisë;
7. Shërbimi i nefrologjisë dhe hemodializës;
8. Shërbimi i anestezisë-reanimacionit;
9. Shërbimi i urgjencave polivalente;
10. Shërbimi i hipertonsisë dhe mjekësisë interne;



11. Shërbimi i alergologjisë;
12. Shërbimi i reumatologjisë;
13. Shërbimi i dermatologjisë;
14. Shërbimi i traumatologjisë;
15. Shërbimi i ortopedisë (SU “Trauma”);
16. Shërbimi i okulistikës;
17. Shërbimi i ORL-së;
18. Shërbimi i kirurgjisë maksilo-faciale;
19. Shërbimi i urgjencës kirurgjikale;
20. Shërbimi i kirurgjisë digjестive;
21. Shërbimi i urologjisë;
22. Shërbimi i djegie-plastikës;
23. Shërbimi i neurologjisë;
24. Shërbimi neurovaskular (stroke dhe poststroke);
25. Shërbimi i neurokirurgjisë;
26. Shërbimi i onkologjisë;
27. Shërbimi i sëmundjeve infektive;
28. Shërbimi i pediatriisë së specialiteteve;
29. Shërbimi i onkohematologjisë pediatrike;
30. Shërbimi i pediatriisë infektive;
31. Shërbimi i urgjencës dhe i pediatriisë së përgjithshme;
32. Shërbimi i kirurgjisë infantile;
33. Shërbimi i reanimacionit pediatrik;
34. Shërbimi i laboratorëve (klinikë - biokimikë, mikrobiologjikë, imunologjikë, atomopatologjikë, gjenetikë mjekësore, laborator i mjekësisë nukleare);
35. Shërbimi i imazherisë dhe i mjekësisë nukleare;
36. Shërbimi i fizioterapisë;
37. Shërbimi i statistikave;
38. Shërbimi i pneumologjisë;
39. Kirurgjia torakale;
40. Shërbimi i ftiziatrisë;
41. Shërbimi i gjinekologjisë;
42. Shërbimi i obstetrikës;
43. Shërbimi i patologjisë së barrës;
44. Shërbimi i neonatologjisë;
45. Shërbimi i farmacisë;
46. Shërbimi i konsultave të specializuara ambulatorë;
47. Shërbimi i toksikologjisë klinike;
48. Shërbimi i psikiatriisë (QSUT);
49. Kontrolli i infeksioneve spitalore;
50. Shërbimi i urgjencës ambulatorë.

II. SPITALET NË NIVEL QARKU (SPITALET RAJONALE)

Spitalet publike të përgjithshme në nivel qarku ofrojnë:

1. Shërbimi i urgjencës;
2. Shërbimi i mjekësisë së përgjithshme;
3. Shërbimi i kirurgjisë së përgjithshme, ortopedi-traumatologji, urologji, ORL, okulistikë, angiologji, max-facial;
4. Shërbimi i obstetrikë-gjinekologjisë;
5. Shërbimi i neonatologjisë;
6. Shërbimi i pediatriisë;
7. Shërbimi i radiologjisë;
8. Shërbimi i fizioterapisë;
9. Shërbimi i anatomisë dhe histologjisë patologjike;
10. Shërbimi i laboratorëve kliniko-biokimike e të mikrobiologjisë;
11. Shërbimi i anestezi-reanimacionit;
12. Shërbimi i farmacisë;
13. Shërbimi i onkologjisë (kimioterapisë, kujdesi paljativ);
14. Kontrolli i infeksioneve spitalore;
15. Shërbimi psiko-social;
16. Shërbimi i konsultave të specializuara (poliklinika e specialiteteve);
17. Banka e gjakut.

III. SPITALET NË NIVEL BASHKIE

Spitalet publike të përgjithshme në nivel bashkie ofrojnë:

1. Shërbimi i urgjencës;
2. Shërbimi i mjekësisë së përgjithshme;
3. Shërbimi i kirurgjisë së përgjithshme;
4. Shërbimi i pediatriisë dhe obstetrikë-gjinekologjisë, neonatologji;
5. Shërbimi i radiologjisë;
6. Shërbimi i laboratorëve kliniko-biokimike e të mikrobiologjisë;
7. Shërbimi i anestezi-reanimacionit;
8. Shërbimi i farmacisë;
9. Shërbimi ambulator i specializuar;
10. Banka e gjakut.

Trajtimi i kimioterapisë do të ofrohet nga pesë spitale: Spitali Durrës, Spitali Vlorë, Spitali Shkodër, Spitali Korçë, Spitali Universitar “Shefqet Ndroqi”.

IV. SPITALET DITORE

1. Ndihmë e parë mjekësore për trajtim dhe kurim brenda 24 orëve.



SHTOJCA NR.2
BUXHETI I SHËRBIMIT SPITALOR 2019

Nr.	INSTITUCIONI	Buxheti					Totali
		600	601	602	604	rezerve	
1	BERAT	253,000	42,250	162,000			457,250
2	BULQIZË	68,250	11,400	30,000			109,650
3	DELVINË	29,600	4,950	5,500			40,050
4	DEVOLL	43,350	7,250	10,000			60,600
5	DIBËR	226,500	37,800	110,000			374,300
6	ELBASAN	386,500	64,500	220,000			671,000
7	FIER	328,600	54,850	170,000			553,450
8	GRAMSH	102,800	17,200	36,000			156,000
9	GJIROKASTËR	177,400	29,700	80,000			287,100
10	HAS	39,100	6,500	12,000			57,600
11	KAVAJË	98,500	16,400	28,000			142,900
12	KOLONJË	76,200	12,700	20,000			108,900
13	KORÇË	362,600	60,550	185,000			608,150
14	KRUJË	109,150	18,200	26,000			153,350
15	KUÇOVË	59,800	9,950	15,000			84,750
16	KUKËS	219,800	36,700	100,000			356,500
17	KURBIN	71,800	12,000	28,000			111,800
18	LEZHË	217,200	36,250	112,000			365,450
19	LIBRAZHID	128,300	21,400	50,000			199,700
20	LUSHNJË	199,200	33,250	100,000			332,450
21	MALËSI E MADHE	20,750	3,460	6,000			30,210
22	MALLAKASTËR	37,550	6,250	11,000			54,800
23	MAT	105,700	17,650	35,000			158,350
24	MIRDITË	90,700	15,150	25,000			130,850
25	PEQIN	32,400	5,400	5,500			43,300
26	PËRMET	70,100	11,700	35,000			116,800
27	POGRADEC	145,200	24,250	70,000			239,450
28	PUKË	83,400	13,900	30,000			127,300
29	SARANDE	132,200	22,000	95,000			249,200
30	SKRAPAR	74,100	12,300	16,000			102,400
31	SHKODËR	460,700	76,900	180,000			717,600
32	TEPELENË	78,200	13,100	16,000			107,300
33	QSUT	1,920,000	310,000	3,000,000			5,230,000
34	SUOGJ "MBRETËRESHA GERALDINË"	270,300	45,100	252,000			567,400
35	SUOGJ "KOÇO GLIOZHENI"	221,300	36,950	160,000			418,250
36	SU "SHEFQET NDROQI"	295,000	48,000	310,000			653,000
37	SU TRAUMA	112,800	18,800	130,000			261,600
38	TROPOJË	90,240	15,000	30,000			135,240
39	VLORE	354,400	59,100	270,000			683,500
40	Paketat e shërbimeve				3,004,597		3,004,597
41	Trajtime me VKM				40,000		40,000
42	Transferta për individët (mjekë specialistë)				50,000		50,000
43	Pagesa të shërbimeve PPP				2,136,975		2,136,975
44	Rezerve					188,140	188,140
	TOTALI	7,792,690	1,288,810	6,176,000	5,231,572	188,140	20,677,212

SHTOJCA NR. 3
LISTA E INSTITUCIONEVE QË NUK DO
TË FINANCOHEN NGA FONDI
I SIGURIMIT TË DËTYRUESHËM TË
KUJDESI SHËNDETËSOR

1. Spitali psikiatrik Vlorë;
2. Spitali psikiatrik Elbasan;
3. Shërbimet e shëndetit mendor në rrethe;

4. Shërbimi i psikiatrisë Shkodër;
5. Qendra Kombëtare e Riatësimi, Mirërritjes dhe Zhvillimit të Fëmijëve;
6. Shërbimi Kombëtar i Transfuzionit;
7. Qendra Kombëtare Biomjekësore.

**VENDIM****Nr. 47, datë 30.1.2019****PËR MIRATIMIN E PAKETËS SË
PROGRAMIT KOMBËTAR TË
DEPISTIMIT TË KANCERIT TË QAFËS
SË MITRËS NË SHQIPËRI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 10138, datë 11.5.2009, “Për shëndetin publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e programit kombëtar të depistimit të kancerit të qafës së mitrës në Shqipëri, si një paketë shërbimesh ndihmëse në shëndetin publik, me qëllim identifikimin e hershëm të dëmtimeve parakanceroze në qafën e mitrës dhe parandalimin e kancerit të qafës së mitrës.

2. Shërbimet e organizuara të këshillimit dhe marrjes së mostrave për ekzaminimin e mëtejshëm laboratorik të testit depistues të HPV-së do të kryhen pranë qendrave shëndetësore të shërbimeve të kujdesit parësor.

3. Interpretimi i testeve laboratorike të HPV-së do të kryhet në mënyrë të centralizuar, në laboratorin qendror pranë Institutit të Shëndetit Publik.

4. Instituti i Shëndetit Publik siguron infrastrukturën e nevojshme laboratorike për ekzaminimin e testeve depistuese të HPV-së.

5. Për gratë e përfshira në këtë program, që rezultojnë pozitive nga depistimi, përcaktimi i diagnozës dhe trajtimi eventuale mjekësor do të kryhet në shërbimet spitalore rajonale dhe universitare publike.

6. Programi të garantojë qëndrueshmëri afatgjatë, rritje të vazhdueshme të mbulesës depistuese dhe cilësi në të gjitha nivelet e shërbimeve shëndetësore publike të përfshira.

7. Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, nëpërmjet njësive vendore të kujdesit shëndetësor dhe në bashkëpunim me Institutin e Shëndetit Publik, duhet të sigurojnë mbështetje për transportin e mjeteve të konsumit pranë qendrave shëndetësore në rajonet e përzgjedhura si dhe transportin e mostrave biologjike në laboratorin qendror, pranë Institutit të Shëndetit Publik.

8. Qendrat shëndetësore duhet të sigurojnë informimin dhe këshillimin e grave të përfshira në program lidhur me procedurën e marrjes së mostrave biologjike për testet depistuese të HPV-së. Mjekët e familjes duhet të informojnë gratë për rezultatet e testit, pozitiv apo negativ, dhe referimin më pas të tyre në strukturat e tjera shëndetësore.

9. Instituti i Shëndetit Publik, spitalet rajonale dhe spitalet universitare gjinekologjike-obstetrikale publike, në Tiranë, në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare të Edukimit në Vazhdim, të sigurojnë trajnimin e duhur për personelin shëndetësor, mjekë dhe infermierë, të këtyre qendrave.

10. Instituti i Shëndetit Publik i propozon Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale shtrirjen graduale të programit të depistimit të kancerit të qafës së mitrës dhe mbështet në vijimësi aktivitetet kombëtare dhe rajonale të ndërgjegjësimit të popullatës për programin.

11. Instituti i Shëndetit Publik i propozon për miratim Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale kornizën teknike të programit për popullatën target, grup-moshën, standardet, mekanizmat e sigurimit të cilësisë, menaxhimin e riskut dhe treguesit e monitorimit të procesit. Instituti i Shëndetit Publik, në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare të Cilësisë, Sigurisë dhe Akreditimit të institucioneve shëndetësore, përditëson në vijimësi kornizën teknike, në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare në këtë fushë.

12. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Instituti i Shëndetit Publik dhe Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

**URDHËR****Nr. 53, datë 29.1.2019****PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE
TË KRYEINSPEKTORIT TË DREJTORISË
SË PËRGJITHSHME TË ARKIVAVE**

Në mbështetje dhe zbatim të nenit 11/b, të ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003, “Për arkivat”, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të nenit 11, pikave 2 dhe 3, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave si Kryeinspektor i Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, z. Endrit Musaj, Drejtor i Inspektimit dhe Trajnimeve, për inspektimet që do të kryhen në Universitetin e Tiranës.

2. Kompetencat e Kryeinspektorit të DPA do të ushtrohen për të gjitha praktikat e inspektimit, sipas ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, ndaj Rektoratit të Universitetit të Tiranës.

3. Për zbatimin e urdhrit ngarkohet drejtori i Inspektimit dhe Trajnimeve, z. Endrit Musaj.

4. Data e fillimit të kompetencave të deleguara është data e hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM
Ardit Bido

URDHËR I PËRBASHKËT**Nr. 54, datë 30.1.2019****PËR MIRATIMIN E FORMATIT TË
PUBLIKIMIT TË TË DHËNAVE TË
DETAJUARA MBI TË ARDHURAT DHE
SHPENZIMET FINANCIARE TË
INSTITUCIONEVE PUBLIKE TË ARSIMIT
TË LARTË**

Në mbështetje të pikës 4 të, nenit 102 të Kushtetutës dhe shkronjës “a”, të pikës 2, të vendimit nr. 781, datë 26.12.2018, të Këshillit të Ministrave “Për garantimin e transparencës në institucionet publike të arsimit të lartë”,

URDHËROJMË:

1. Miratimin e formatit dhe mënyrës së publikimit të të dhënave të detajuara, mbi të ardhurat dhe shpenzimet financiare të institucioneve publike të arsimit të lartë, mbi bazë mujore.

2. Formatit i publikimit, i cili do të përmbajë të dhëna të detajuara mbi të ardhurat dhe shpenzimet e institucioneve publike të arsimit të lartë, kryhet sipas aneksit A, bashkëlidhur këtij urdhri.

3. Brenda datës 15 të çdo muaji, raportimi financiar nga institucionet publike të arsimit të lartë sipas përcaktimeve të pikës 2 të këtij urdhri, rakordohet me degën e thesarit përkatëse dhe publikohet në faqen zyrtare të IAL-së përkatëse.

4. Brenda datës 20 të çdo muaji, institucionet publike të arsimit të lartë përcjellin raportimin financiar sipas pikave 2 dhe 3 të këtij urdhri, në format elektronik pranë Qendrës Ndërinstitucionale të Rrjetit Akademik Shqiptar, e cila e publikon në faqen e saj zyrtare.

5. Administratorët e institucioneve publike të arsimit të lartë, pasqyrojnë dhe përditësojnë sipas afateve të përcaktuara të dhënat sipas këtij udhëzimi edhe pranë Qendrës Ndërinstitucionale të Rrjetit Akademik Shqiptar.

6. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, institucionet publike të arsimit të lartë dhe Qendra Ndërinstitucionale e Rrjetit Akademik Shqiptar.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT SPORTIT DHE RINISË
Besa Shahini

MINISTRI I FINANCAVE DHE EKONOMISË
Anila Denaj



ANEKSI A

UNIVERSITETI _____ / FAKULTETI _____

TË DHËNA PROGRESIVE PËR PERIUdhËN _____ 2019

Përshkrimi (sipas kombinimit të strukturës kontabël)	Janar		Shkurt		Mars		Qershor		Korrik		Gusht		Shtator		Tetor		Nentor		Dhjetor	
	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
TË ARDHURAT	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Të ardhurat nga tarifat e shkollimit, për të gjitha ciklet e studimit;																				
Të ardhura nga tarifa e regjistrimit																				
Të ardhurat nga konkurset e pranimit;																				
Të ardhura nga qiratë;																				
Të ardhurat nga shërbimet e ndryshme të IAL-së;																				
Të ardhura nga donacione; sponsorizime;																				
Të ardhurat nga projekte me financim të brendshëm apo të huaj;																				
Të ardhura nga veprimtari kërkimore-shkencore;																				
Të ardhura të tjera (në varësi të dinamikës së veprimtarisë së IAL-së)*																				
Shpenzimet nga Granti i Buxhetit të Shtetit	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Shpenzimet për ndërtim																				
Shpenzimet për rikonstruksione,																				
Shpenzimet për blerje biblioteka,																				
Shpenzimet për blerje aparate, pajisje kompjuterike,																				
Shpenzimet për blerje programe e softe kompjuterike etj.																				
Shpenzimet për blerje pajisje, mobilie etj.																				
Shpenzimet e personelit për: paga, orë jashtë kohës normale të punës,																				
shpërblime të tjera (për dalje në pension, sëmundje të rëndë apo rast																				
fatkeqësie në familje);																				
Shpenzimet për kontributin e sigurimeve shoqërore e shëndetësore ;																				
Shpenzimet për blerjen e materialeve dhe kryerjen e shërbimeve, të																				
nevojshme për funksionimin e veprimtarisë së përditshme të institucionit																				
(ujë, energji elektrike, shpenzime telefonike, posta, ngrohje, shërbime të																				
sigurimit dhe ruajtjes, kancelari, materiale zyre, karburant, pjesë këmbimi																				
etj.)																				
Shpenzimet për dieta e udhëtime për punonjësit e institucionit kur largohen																				
jashtë qendrës së punës ose jashtë shtetit për çështje pune.																				
Shpenzimet për qiramarrje ambientesh, pajisjesh, mjete transporti etj.																				
Shpenzimet për ekzekutim të vendimeve gjyqësore për largime nga puna,																				
ekzekutim të detyrime kontraktuale të papaguara;																				
Shpenzimet për honorare; pagesa e bordeve të organeve kolegjiale të																				
institucionit;																				
Shpenzimet për pagesat për veprimtaritë kërkimore-shkencore.																				
Shpenzimet për bursat e studentëve																				
Shpenzimet për bursat e ekselencës																				
Shpenzime të tjera (në varësi të dinamikës së veprimtarisë së IAL-së)*																				
Shpenzimet nga të ardhurat e veta	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Shpenzimet për ndërtim																				
Shpenzimet për rikonstruksione,																				
Shpenzimet për blerje biblioteka,																				
Shpenzimet për blerje aparate, pajisje kompjuterike,																				
Shpenzimet për blerje programe e softe kompjuterike etj.																				
Shpenzimet për blerje pajisje, mobilie etj.																				



Shpenzimet e personelit për: paga, orë jashtë kohës normale të punës, shpërblime të tjera (për dalje në pension, sëmundje të rëndë apo rast fatkeqësie në familje); Shpenzimet për kontributin e sigurimeve shoqërore e shëndetësore ; Shpenzimet për blerjen e materialeve dhe kryerjen e shërbimeve, të nevojshme për funksionimin e veprimtarisë së përditshme të institucionit (ujë, energji elektrike, shpenzime telefonike, posta, ngrohje, shërbime të sigurimit dhe ruajtjes, kancelari, materiale zyre, karburant, pjesë këmbimi etj.) Shpenzimet për dieta e udhëtime për punonjësit e institucionit kur largohen jashtë qendrës së punës ose jashtë shtetit për çështje pune. Shpenzimet për qiramarrje ambientesh, pajisjesh, mjete transporti etj. Shpenzimet për ekzekutim të vendimeve gjyqësore për largime nga puna, ekzekutim të detyrime kontraktuale të papaguara; Shpenzimet për honorare; pagesa e bordeve të organeve kolegjalë të institucionit; Shpenzimet për pagesat për veprimtaritë kërkimore - shkencore. Shpenzimet për bursat e studentëve Shpenzimet për bursat e ekselencës Shpenzime të tjera (në varësi të dinamikës së veprimtarisë së LAL-së)*									
---	--	--	--	--	--	--	--	--	--

Shënim:

* Përshkrimet e tabelës mund të shtohen në varësi të zërave specifike të të ardhurave dhe shpenzimeve të regjistruara nga çdo LAL, bazuar në veprimtarinë konkrete që kryen secili prej tyre.

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2019

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 112 lekë